



QYTETI I SHKUPIT

Nr. 08-13/33/2

02. 12. 2025

Shkup

Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02) dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 202/24) dhe në lidhje me Nenin 20-g të Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19, 14/20 dhe 208/24), Qyteti i Shkupit shpall

SHPALLJE PUBLIKE nr.02/2025 **për punësimin e punëtorit në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar**

Përcaktohet nevoja për punësimin e punëtorit në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar për vendin e punës të mëposhtëm:

1. Emërtimi i vendit të punës **Higjienist/e**, shifra UPR 0405A03004, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i përmbaruesve (1).**

Kandidati është e nevojshme t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë nënshetetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të veçanta:

- arsim fillor
- me ose pa përvojë pune

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Higjienist/e - 42.837,00 denarë.

Orari i kohës së punës - 8 orë në ditë, 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten nga ora 12:30 deri në orën 20:30.

Kandidatët mund ta shkarkojnë **Aplikimi për punësim për shpalljen publike nr. 02/2025** nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk ose ta marrin në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën Bul. Ilinden nr.82, Shkup.

Kandidatët janë të obliguar përveç aplikimit për punësim sipas shpalljes publike nr. 02/2025, të depozitojnë edhe dëshmitë për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura në origjinal ose kopje të noterizuara si më poshtë:

- dëshmi për shtetësi;

- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e nivelit adekuat të arsimit;
- dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore.

Kandidatët nëse kanë përvojë pune është e nevojshme të depozitojnë edhe dëshmi për përvojë pune të evidentuar në Agjencinë e Punësimit.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara duhet t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. "Ilinden" nr. 82, Shkup me shënimin - për **Shpallje publike nr.02/2025 dhe numrin rendor të vendit të punës për të cilin kanë aplikuar.**

Afati i aplikimit është 5 ditë pune nga dita e shpalljes së shpalljes publike. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e specifikuara në shpallje në momentin e depozitimit të aplikimit.

Vërejtje: Nëse kandidati në aplikim nuk ka depozituar të dhëna për kontakt (numër telefoni ose adresë e-mail) aplikimi do të refuzohet.

Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:

Faza 1: Verifikimi i aplikimeve dhe dëshmime – realizohet në një afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të shpalljes publike. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni përzgjedhës do të kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose numrit të telefonit të dhënë në aplikim. Kandidati është i obliguar që në afat prej tri ditësh të kompletojë dëshmitë, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: Intervista me kandidatët të cilët kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes – realizohet në afat prej 10 ditësh pas realizimit të fazës së parë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës për përzgjedhje janë rregulluar në **Rregulloren për punësimin e personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit** nr. 08-12594/1 datë 19.11.2024, të shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).



QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT


Orce Gjorgjievski